

URDHËR
Nr. 78, datë 30.1.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 166, DATË 27.4.2022, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, “PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE KARAKTERISTIKAT E TJERA TË VULËS DHE RREGULLAT PËR PAJISJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE, SI DHE FORMËN E KARTËS SË IDENTIFIKIMIT TË PËRKTHYESIT ZYRTAR DHE INTERPRETIT TË GJUHËS SË SHENJAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetues; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 166, datë 27.4.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për formën, përmbajtjen dhe karakteristikat e tjera të vulës dhe rregullat për pajisjen dhe administrimin e tyre, si dhe formën e kartës së identifikimit të përkthyesit zyrtar dhe interpretit të gjuhës së shenjave”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Shtojca nr. 1, bashkëlidhur urdhrin nr. 166, datë 27.4.2022, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë, interpretët e gjuhës së shenjave, Drejtoria e Përkthimit Zyrtar për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor dhe Certifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË NR. 1
FORMA DHE PËRMBAJTJA E VULËS SË PËRKTHYESIT ZYRTAR

Vula e përkthyesit zyrtar ka ngjyrë blu dhe formë rrethore me diametër 35 mm. Brenda saj në pjesën e sipërme shkruhen me shkronja të mëdha në formë të harkuar fjalët “PËRKTHYES ZYRTAR I GJUHËS”. Në mes të rreshtit, me shkronja të mëdha, shkruhet emri dhe mbiemri i përkthyesit zyrtar. Poshtë emrit shkruhet “certifikatë nr.” ku shënohet numri i certifikatës së përkthyesit zyrtar. Në pjesën e poshtme të rrethit në formë të harkuar të shkruhet me shkronja të mëdha në vend të fjalës “GJUHA”, gjuha për të cilën është certifikuar përkthyesi.

